

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti përgjithshëm penal**, duke vendosur sipas gjyqtarit Skender Shefkiu me asistenten Ajshe Bekteshi në çështjen penale të akuzuarit L.H nga fsh.B. Komuna e V. për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së PTHSH nga Gjilani, PP.II.nr.1703/2014, të datës 03.11.2014, të përfaqësuar nga I.U., pas mbajtjes së shqyrtimit Kryesor, më 17.01.2017 shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M I**

**I akuzuari L.H.**, nga babai N. dhe nenes H., e vajzerise B. , i lindur me: ”data e lindjes”..., ne Gj. me vendbanim te perhershem ne fsh.B Komuna V., eshte student , i papune, I pa martuar, me gjendje te dobet ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikes Kosoves.

**ËSHTË FAJTORË  
SEPSE**

Me dt; .././2014, rreth ores ... min, në , V., i pandehuri duke drejtuar automjetin e tij të markes Opel Astra, me targa të regjistrimit ”...”, nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerzëve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyre që duke u kyqur nga rruga dytësore në rrugën kryesore duke mos rrespektuar anën me përparsi kalimi në udhëkryqë, ku një veprim i till është në kundërshtim me nenin 64 parag 4 të ligjit për sigurinë e komunikacionit rrugor të Kosovës, ashtu që me automjetin e tij e godet automjetin e markës Mercedes, me tabela regjistrimit ”...”, të cilën e drejtonte i dëmtuari A. H., e që levizte në rrugën kryesore “V-G”, si pasojë e këtij aksidenti përveq dëmeve materiale të shkaktuara, lëndim të lehta trupore pëson vetë i pandehuri dhe pasagjerja e tij H.H., të cilët për shkak të natyrës së lëndimit detyrohen të kërkojnë ndihmë mjeksore në qendrën Shtëpia e Shëndetit në Viti.

Me çka ka kryer veprën penale, **rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.**

-Andaj Gjykata në bazë të nenit 41,46, 73, 74, e 75 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPRK-së,

**E G J Y K O N**

**Me dënim burgu në kohë zgjatje prej 90 ditësh.**

Dënimet e shqiptuara nuk do të ekzekutohet **me KUSHT që brenda 1 viti** mos te kryej veper tjeter penale (koha e verifikimit).

**Obligohet** i akuzuari ti paguaj Gjykatës shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, dhe shpenzimet për ekspertizë të komunikacionit në shumë prej 100 Euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Të dëmtuarit A.H. nga fsh.S, Komuna e.F., dhe H.H. nga fsh.B, Komuna e V., për kërkesën pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

PTHSH nga Gjilani me aktakuzën , PP.II.nr.1703/2014, të datës 03.11.2014, e ka akuzuar akuzuarit L.H. nga fsh. B., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

**Prokurori I.U.** në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Mbetet në tersi pranë aktit akuzues dhe propozimeve që e njejta i përmban sa i përket fajsisë dhe denimit për të pandehurin për veprën penale të kryer pasi që gjendja faktike në këtë qeshëje penale juridike u vertetua me pranimin e fajsisë nga vetë I akuzari, pranimi ky që është në përputhshmeri të plotë edhe në provat tjera që tani janë propozuar dhe shtjelluar si prova. Me rastin e denimit dhe matjes së denimit të mirën parasysht gjitha rrethanat mesazh e se ciles posaqerisht lehtesuse ti miret parasysht fakti se I njejti ishte korrekt para gjykatës shprehi pendim publik për veprën e kryer, premtoj se nuk do të perseritet vepra të tilla apo të ngjajshme në të ardhmen dhe ajo që është me rëndësi e pranoi fajsin për veprën penale të kryer.

**Fjala përfundimtare të akuzuarit L.H.:** ka kërkuar nga gjykata që të i shqiptoj një dënim sa më të butë, për veprën penale të cilën e ka kryer është penduar, nuk do të përserisë me këtë veprë e as vepra të tjera penale, me gjendje të vështirë ekonomike, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin.

Gjykata pas vlersimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës e pasi që i akuzuari ka pranuar në tersi veprën penale, pranimin e fajsisë e cila është bërë në përputhje me dispozitat e nenit 246 të KPRK-ës, e që i vihet në barë Gjykata u përqendrua në vendosjen vetëm përkitazi mbi matjen dhe lartësinë e denimit konform nenit 74 të KPRK-ës, dhe nenit 75 të KPK-ës, kështu me rastin e caktimit të lartësisë së denimit Gjykata pati parasysht rrethanat lehtesuse dhe ato rënduse, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e denimit.

Si rrethanë lehtësuese pranimin e fajsisë, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të këtij lloji e as të tjera, është hera e parë që përballë me Ligjin, dhe ka premtuar se tash e tutje nuk do të bie ndesh me ligjin, me gjendje të vështirë ekonomike. Si rrethanë rënduese shkalla e përgjegjësisë penale dhe dëmi i shkaktuar të dëmtuarës.

Bindja e Gjykatës së denimi i shqiptuar është i ligjshëm, është në proporcion me veprën penale, përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se me denimin e tillë të shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij denimi.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN- DEGA NË VITI**

**P.nr. 659/2014**

**Me dt.17.01.2017**

**Asistentja,  
Ajshe Bekteshi**

**Gj y q t a r i,  
Skender Shefkiu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankes në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të Aktgjykimit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmes të kësaj Gjykate.